

Ruzhdi Jashari, Phd kandidat

Mbrojtja Ligjore e të Dhënave Personale dhe e Privatësisë - Element me Rëndësi në Proceset Integruese Evropiane

Të dhënat personale, privatësia e individit dhe të dhënat e ndjeshme/sensitive kanë zanafillë të hershme të kujdesit ligjor. Në këtë kuadër nëpër shumë ligje të fushave të ndryshme ishin vendosur dispozita dhe nene të caktuara, s: në Ligjin për Shërbimit Civil, në ligjet që kanë rregulluar aspekte të caktuara të fushave të sigurisë, kodin penal, kodin civil, etj, të cilat kanë rregulluar çështje të caktuara lidhur me natyrën e të dhënave personale. Për nderin dhe dinjitetin e individit edhe kodet e hershme juridike të popujve të ndryshëm qysh nga Mesjeta dhe para saj kishin rregulluar aspekte të kësaj natyre.

Mirëpo, zhvillimet e shpejta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit shtruan nevojën e domosdoshme që të dhënat personale dhe privatësia e individit, të trajtuara në thelb si liri fundamentale të njeriut, të merren nën mbrojtje insitucionale me një kuadër ligjor të veçantë.

Ndër shtyllat serioze të Bashkimit Evropian, sikurse ajo e Bashkimit Ekonomik, ajo e politikës së jashtme të përbashkët dhe të sigurisë, është shumë e rëndësishme edhe ajo e sitemit të drejtësisë së BE-së, e konsideruar si shtylla e tretë e drejtësisë dhe e çëhtjeve të brendshme,¹ e cila, në kuadër të vet ka edhe materien e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë, apo siç quhet ndryshe, të “intimitetit”.

Për bashkimin monetar, sikurse edhe për atë doganor, që shpesh thuhet se kanë pasur ndikim pozitiv në përshpejtimin e integritit të BE-së, nje konstatimi i këtillë lirisht mund të nxirret edhe për fushën e mbrojtjes së të dhënave, ku në mënyrë edhe më të përshpejtuar mund të sjellë integrimin e BE-së, me vet faktin që të dhënat personale gradualisht po vihen në një qendër kontrolli të sistemit biometrik të dokumenteve personale të qytetarëve në nivel evropian.

Neni 108 i Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, duke qenë një ndër çështjet bazë të themelimit të Bashkimit Evropian, ku shprehimisht thuhet se “Unioni është themeluar mbi bazën e demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe shtetit të së drejtës, parime që janë të përbashkëta për shtetet anëtare” dhe se “Unioni respekton të Drejtat Themelore të Lirive të Njeriut ashtu siç janë garantuar me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ashtu siç është nënshkruar në Romë, më 04 nëntor 1950”², e cila hyri në fuqi më 03 shtator të vitit 1953.

Ndërkohë që baza për mbrojtjen e të dhënave personale dhe e privatësisë së individit vjen nga neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, ku

¹ Dr. Marko Bello, E DREJTA INSTITUCIONALE KOMUNITARE EUROPIANE, Tirane, 2010, f.291

² Po aty, f.108

thuhet se “gjithkush ka të drejtë në respektimin e jetës së tij private dhe familjare shtëpinë e tij dhe korrespondencën e tij”³. Kjo konventë ishte bërë pikë referimi për më tepër se 40 vende evropiane, duke ndikuar legjislacionin përtej kufijve evropian lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale për më tepër se 30 vjet rresht, deri te nxjerrja e Direktivës së Bashkimit Evropian 95/46, si legjislacion sekondar i të drejtës komunitare evropiane, me fuqi vepruese, duke u shtrirë në legjislacionet e shteteve anëtare, në mënyrë detyruese tek shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Duhet theksuar se Direktiva 95/46, mbështetjen direkte të bazës ligjore e vendosi në dy segmente kryesore në nevojën e përshpejtuar për të mbrojtur privatësinë e individit nga eksplodimi marramendës i zhvillimit të teknologjisë dixhitale të informimit dhe komunikimit, si nevojë e ngutshme nga presioni i zhvillimit teknologjik nga njëra anë dhe në aktin e Konventës 108, të 28 janarit të vitit 1981, të Këshillit të Evropës, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale.⁴

Data 28 janar tash festohet edhe si Dita Evropiane e Privatësisë nga të gjithë komisionerët dhe agjencitë apo autoritetet e mbrojtjes së të dhënave personale, në nivel evropian dhe më gjerë.

Në vitin 2001, organet e Bashkimit Evropian caktuan kontrollorin apo kontrolluesin evropian, në përputhje me nenin 46 dhe 47 të T.K.E. për mbrojtjen e të dhënave personale⁵, i cili do të merret me mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë për të siguruar që institucionet dhe organizmat e BE-së respektojnë në mënyrë rigorozë të drejtën për privatësi, sa herë që ato përpunojnë të dhëna me karakter personal.

Në të gjitha vendet e BE-së dhe ato përtej kufijve të BE-së, deri te nxjerrja dhe ratifikimi i Konventës 108 të KE-së për përpunimin automatik të të dhënave personale dhe më vonë edhe Direktivës EC 95/46, çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë nuk e kishin të rregulluar në legjislacionin e tyre në mënyrë unike, ndërkohë që pothuajse në të gjitha kushtetutat e vendeve të BE-së, ishin të vendosura dispozita që garantonin privatësinë e individit dhe fshetësinë e korrespondencave të tija dhe të drejtën e pacenuar të banesës/banimit të tij.

E drejta e privatësisë e garantuar me nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e drejta themelore për lirinë e shprehjes, që është e garantuar me nenin 10, duke i “konkuruar” njëra trjetrës, *reflektojnë diversitetin dhe kompleksitetin e shekullit XXI*⁶, deklaroi z. Thorbjom Jagland, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës në fjalimin e tij të mbajtur në Bruksel më 28 janar 2010, me rastin e Ditës së Privatësisë.

Gjithashtu, në nevojën e domosdoshme të përligjjes duhet të zëjë vend në strukturë legjislative edhe e “drejta e harresës” apo e “drejtë për të harruar”, që shpesh të dhënat

³ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirite Themelore, e miratuar dhe hyre në fuqi, me 03 shtator, 1953, Rome.

⁴ Konventa 108 e Këshillit të Evropës, e hyre në fuqi më 28 janar 1981.

⁵ Dr. Marko Bello E DREJTA KOMUNITARE EVROPIANE, Tirane, 2010, f. 274

⁶ Deklarat e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Z. Thorbjom Jagland, mbajtur me rastin e Dites Evropiane të Privatësisë në Bruksel

në distanca të gjata kohore për individin janë edhe pengesa të pakapërcyeshme që sfidojnë vet përparimin dhe pozitën e tij synuese në shoqëri.

Prandaj, ekziston arsyeja e fortë dhe nevoja e *“domosdoshme që në një dokument ndërkombëtar detyruet të përcaktohet e drejta e bilancit në mes të dy të drejtave themelore: të drejtës së privatësisë dhe të drejtës së lirisë së shprehjes”* deklararon në fjalimin e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, z. Th. Jagland në Bruksel, më 28 janar, 2010.

Gjykuar në përgjithësi me realizëm dhe në balancin veprues në fushën e sundimit të ligjit, pa e cenuar lirinë e lëvizjes, të drejtat themelore të njeriut, të drejtën e mendimit dhe të shprehjes, në korpusin e vlerave të përgjithshme të demokracisë dhe lirisë në një përfundim të qartë, do të nxirret konkludimi si në vijim:

E vetmja rrugë e drejtë për të bërë balancimin (ekuilibrin) në mes të *lirisë së shprehjes* dhe të *drejtës së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale* është që të miratohet (nxirret) një TRAKTAT NDËRKOMBËTAR obligativ ose rregullorë e karakterit veprues ndërkombëtar, që ka rolin e ligjit ndërkombëtar primar/obligativ.

Sidoqoftë, konkretizimet individuale të legjislacionit gjatë adaptimit/përshtatjes së direktivës EC 95/46, në sferën juridike të shteteve veç e veç në kuadër të BE-së me Ligjin për Mbrojtjen të Dhënave, do të marrin fund dhe diskrepancat ligjore në fushën e privatësisë do të përfundojnë kur të miratohet një rregullorë e standardizuar⁷, si akt primar në kuadër të së drejtës komunitare evropiane, e cila do ta zëvendësonte Direktivën e deritashme 95/46 që ka rolin e aktit sekondar në të drejtën komunitare evropiane.

Këto iniciativa tashmë janë duke u zhvilluar dhe konkretizimi i modernizimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave pritet në një afat kohor të procedimit deri të miratimi dhe hyrja në fuqi në një periudhë 2- 4 vjeçare. Deri të koha e nxjerrjes së këtij legjislacioni *“shtepia evropiane”* dhe shtetet në *“oborrin”* e kësaj *“shtëpie”*, kanë mjaft punë në organizimin institucional, në draftimin, propozimin dhe përshtatjet në parimet e deritashme të konventave dhe direktivave në fushën e mbrojtjes dhe përpunimit të të dhënave personale dhe të privatësisë.

Shkeljet e të drejtave të privatësisë mund të adresohen edhe në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë (GjED), nëse shkeljet e këtilla kanë përfunduar të *“pasukseseshme për subjektin e të dhënave”* të sistemi i drejtësisë i shtetit anëtar i BE-së. Meqk Komuniteti evropian nuk e ka një ndarje të prerë të gjykatave, GjED kryen një sërë rolesh duke vepruar edhe si gjykatë kushtetuese, gjykatë administrative, gjykatë arbitrazhi dhe si gjykatë këshilluese⁸.

⁷ Promovimi i të Drejtave të Privatesise në Kosovë, Konferencë e Organizuar nga *“Lens”*, Progress through responsible use of modern technology, financuar nga Fondi Sorros për Shoqëri të Hapur, mbajtur në Prishtinë në Korrik, 2012, f. 4.

⁸ BASHKIMI EUROPIAN, Perkteu Uke Zenel Buqpapaj. Botoi, Qendra Nderkombetare E Kultures *“Arbnori”*, Tirane, 2010. Titulli origjinal: *Europien Union*, Redaktor: Muje Buqpapaj, Recensent: Sabah Jamisha, Arti Grafik: *“Kokollari International”*. Faqe. 307 dhe 308.

Prandaj, "lëvizja e lirë e mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitalit kërkon, jo vetëm që të dhënat personale duhet të qarkullojnë lirshëm nga një shtet anëtare te shteti tjetër, por gjithashtu të drejtat themelore të individëve duhet të jenë të garantuara"⁹, duke kontribuar kështu në progresin ekonomik dhe social, ekspansionin tregtar dhe mirëqenien e individëve. Fuqizimi institucional ligjor në fushën e të dhënave personale, padyshim do të sjellë përfitime të shumëfishta në tri shtylla për të gjitha shtetet dhe të gjithë qytetarët në BE dhe përtej BE-së në drejtësi, siguri dhe liri themelore të njeriut.

Privatësia dhe të Dhënat Personale, të Drejta Themelore të Njeriut

E vetmja pronë personale që lidhet direkt me individin dhe është në pronësinë e tij të përvetshme janë të dhënat personale dhe jeta e tij shpirtërore, materiale, intelektuale, kulturore duke përfshirë botën e tij të brendshme/sensitive. Këto të drejta qëndrojnë në themelet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në gjuhën e përditshme te ne, me këto të drejta nënkuptojmë *sedrën e individit*. Thënë në gjuhën e terminologjisë juridike edhe në aspektin ndërkombëtar, lirisht qëndron shprehja *privatësi* për individin, po që se shkilet apo keqpërdoret nga kushdo qoftë, atëherë kemi të bëjmë me shkeljen e *privatësisë* që herë herë asocion me të kuptuarit se "nderi ynë" është nëpërkëmbur apo shkelur.

Shprehja e përdorur në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, *të dhëna personale*, të Republikës së Kosovës nënkupton:

"Çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikueshëm ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror."¹⁰

Shikuar edhe legjislacionet e shteteve tjera në rajon dhe më gjerë, interpretimi ligjor i shprehjes *të dhëna personale* ka të njëjtin interpretim.

Në kuadrin e të drejtave të subjekteve, e drejta civile, duke rregulluar normat juridike në rendin shoqëror të shumë sistemeve shtetërore juridike ka rregulluar në mënyrë specifike të drejtën pasurore dhe jopasurore. Pra, normat e të drejtës civile i rregullojnë edhe disa të drejta jopasurore të cilat quhen:

"të drejta personale jopasurore, që është e drejta e emrit, e pseudonimit, e banimit, e autorit, e nderit etj. Kuptimi i fjalës 'personale' tregon lidhjen që ka kjo e drejtë me një person të caktuar."¹¹

Në kornizat kushtetuese, si akte juridike më të larta të shteteve, e drejta e privatësisë zë vendin qendror. Ndërkaq, në legjislacionin sekondar, kjo e drejtë i nënshtrohet normave

⁹ Direktiva 95/46 e KE e Parlamentit dhe e Keshillit e 24 Tetorit 1995, f.1

¹⁰ Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, i shpallur në Fletoren Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr.70 / V/, i hyrë në fuqi në Maj, 2010, Prishtinë

¹¹ Valentina Kondili E DREJTA CIVILE I Pjesa e përgjithshme, Ribotim, Geer, 2008, Tirane, f. 99.

juridike nëpër shumë të drejta, si: e drejta civile, e drejta familjare, e drejta penale, e drejta e trashëgimisë, etj. Por, që nga viti 1981, e drejta personale dhe e privatësisë rregullohen me ligje të veçanta, veçmas në Evropë, ku detyrimet për rregullim ligjor në këtë fushë dalin nga Direktiva për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Privatësisë 95/46.

Por, dy termet “privatësi” dhe “të dhënat personale” edhe pse në përgjithësi kushtetutat e vendeve të BE-së dhe të shumicës së vendeve tjera jashtë BE-së, duke përfshirë edhe legjislacionin e tyre primar dhe sekondar, i trajtojnë të pandara dhe në një kuptim të pandarë. Të njëjtin trajtim e bën edhe legjislacioni i sistemit të drejtësisë në BE; këto terme, në esencë kanë kuptime të ndryshme dhe që të dyja lidhen për individin/personin.

Të Dhënat Personale

Definicioni mbi “të dhënat personale”, mbi të gjitha, është me interes parësor për t’u kuptuar saktësisht, veçmas kur kemi të bëjmë me materien, të cilën e kemi shtruar për studim dhe funksionin që kanë të dhënat personale në tërësi në legjislacionin e sistemit të drejtësisë pa përjashtim brenda BE-së, si dhe jashtë saj, duke përfshirë edhe vendet e rajonit tonë.

Kush trajtohet, në fakt, si e dhënë personale? Përveç “emrit dhe mbiemrit që konsiderohen të drejta personale, jopasurore. Ato janë të lidhura pazgjidhshmërisht (pandashëm) me personin dhe nuk mund të tjetërsohen. Edhe pseudonimi i përdorur nga personi fizik e gëzon të njëjtën mbrojtje.”¹²

Andaj, mund të themi se kur kemi të bëjmë me mbrojtjen ligjore, ligji vlenë vetëm atëherë kur informatat që i përpunojmë janë “të dhëna personale”. Nëse informatat që i përpunojmë nuk janë të dhëna personale, atëherë ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk vlenë, dhe të dhënat mund të përpunohen pa fuqinë ligjore të ligjit përkatës (përpos nëse kemi të bëjmë me aplikimin e ligjeve tjera).

Të dhënat të cilat e identifikojnë individin apo personin fizik dhe lidhen për të quhen të dhëna personale. Kjo do të thotë se informatat duhet të jenë personale *për* personin fizik.

Mirëo, edhe të dhënat mund të jenë edhe të dhëna relevante të lidhura për personin dhe si të tilla trajtohen të dhëna personale, kështu që në komentimin e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Maqedonisë gjejmë se:

“ ajo çka është relevante është a janë të dhënat gjegjëse (që merren) me atë person”¹³.

Kështu vimë te përfundimi se përveç të dhënave të fotografisë, emrit, vijave papilare, retinës së syrit, grupit të gjakut, ADN-së, datëlindjes, gjurmëve të gishtave, zërit të personit, si të dhëna personale nga ky komentim ligjor profesional mund te

¹² Valentina Kondili E DREJTA CIVILE I Pjesa e përgjithëshme, Ribotim, Geer, 2008, Tirane, f. 124 dhe 125.

¹³ DZLP, KOMENTAR Na zakonot za Zaštita na ličnite podatoci, Skopje, 2010, f. 10

konsiderohen edhe mendimi për individin edhe % (përqindjet) e theksuara në komentime të ndryshme kur lidhen për individin, ndarja në grupe, apo e grupeve, në komentime të natyrës së ndryshme për personat/individët.

Prandaj, individi mund të identifikohet direkt nga të dhënat direkte identifikuese, siç janë: emri dhe mbiemri i tij, adresa e tij, numri personal i tij, fotografia, ADN-ja, zëri i tij, retina e syrit, etj. Por, mund të identifikohet edhe në mënyrë indirekte, p.sh. nga aspekte dhe rrugë tjera, si: përmes numrit të telefonit të tij, nga organizata ku ka dhënë numrin e tij telefonik, ose të regjistrave të telefonit, përmes të dhënave (adresës) ku ka mbaruar studimet kohë më parë, përmes të dhënave që ka lënë në spital kur personi ka qenë klient në ndonjë klinikë nga evidenca e sistemit bankar ku personi ka lënë numrin e tij të telefonit apo adresën personale. Gjithashtu, identifikimi i personit mund të vie edhe nga rrugëv të tjera siç janë: zgjedhja e ushqimit, pasioni, veprimtaria e tij (politike, fetare, publicistike, shkencore, profesionale, etj), përmes sëmundjes së tij, nofkës (emërtime dytësore përkëdhelëse apo përulëse). Edhe të dhënat që kanë fokus individin, që kanë të bëjnë me individin, që e identifikojnë individin, gjithashtu bëjnë pjesë në të dhënat personale të personit fizik.

Ndërsa zhvillimi i shkencave mbi njeriun, si: Antropologjia, Mjekësia Ligjore, Anatomia, Fiziologjia, Gjenetika, Ortopedia dhe shkencat tjera të mjekësisë mbi autopsinë e nxjerrin edhe ADN-në, llojin dhe grupin e gjakut, si të dhëna identifikuese, gjithashtu personale që lidhen me individin dhe si të tilla identifikojnë personin. Por, që sigurisht nuk do të jetë e largët dita kur edhe qelizat e njeriut të jenë të përfshira si të dhëna personale, nga se si të tilla përcaktojnë trashëgiminë dhe të ardhmen shëndetësore dhe personale të personit.

Andaj, në përpjekje të qëndersimit të sistemit dhe menaxhimit me të dhënat personale, sot janë avancuar sisteme të veçanta të grumbullimit, evidencimit dhe të regjistrimit civil të të dhënave personale dhe në këtë drejtim Evropa po bën përgatitjet finale të aplikimit të sistemit biometrik të të dhënave personale me qëndërsim në Bruksel.

Fotografia e individit e standardit ISO, gjurmët e gishtërinjve, emri dhe mbiemri, vendi i lindjes dhe datëlindja, të vendosura në një çip, në një kartelë identiteti të kualitetit të lartë do të përbëjnë të dhënat personale të individit, në një sistem unik të një programi unifikues civil në nivel evropian. Këto të dhëna janë personale dhe pronë individuale e individit, ndërsa mbrojtja e privatësisë dhe të dhënave personale në këtë drejtim janë në referencë me legjislacionin e Direktivës EC 95/46 të Këshillit të Evropës.

Tashmë edhe në vendet tona të rajonit, si: Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi e Kosovë janë nxjerrë ligjet për mbrojtjen e të dhënave personale, janë themeluar autoritetet dhe në këtë drejtim, përmes marrëveshjeve bilaterale të bashkëpunimit, janë vendosur linjat e forta të bashkëpunimit ndërinstucional në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në pëeputhje të plotë me legjislacionin e BE-së. Ky proces, që në esencë prekë të drejtat themelore të njeriut në lëvizjen e lirë të kapitalit dhe të individit, po konsiderohet një ndër elementet kryesore në integrimet evropiane. Në rajon, tani praktikisht është vendosur bashkëpunimi në sferën e zhvillimit të legjislacionit në përputhje të plotë me

Direktivën për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, paraprakisht duke përsheptuar, trasuar dhe nxitur integrimet në Bashkimin Evropian.

LITERATURA E PERDORUR

1. Dr. Marko Bello, E DREJTA INSTITUCIONALE KOMUNITARE EUROPIANE, Tiranë, ribotim, 2008.
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Lirite Themelore, e miratuar dhe hyrë në fuqi, më 03 shtator, 1953, Romë.
3. Konventa 108 e Këshillit të Evropës, e hyrë në fuqi më 28 janar 1981.
4. Promovimi i të Drejtave të Privatësisë në Kosovë, Konferencë e Organizuar nga "Lens", Progress through responsible use of modern technology, financuar nga Fondi Soros për Shoqëri të Hapur, mbajtur në Prishtinë në korrik, 2012.
5. BASHKIMI EUROPIAN, Perktheu Ukë Zenel Buqpapaj. Botoi, Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Arbnori", Tiranë, 2010. Titulli origjinal: "European Union", Redaktor: Mujë Buqpapaj, Recensent: Sabah Jamisha, Arti Grafik: "Kokollari International",
6. Dr. Marko Bello E DREJTA KOMUNITARE EVROPIANE, Tiranë, 2010
7. Deklaratë e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Z. Thorbjom Jagland, mbajtur me rastin e Ditës Evropiane të Privatësisë në Bruksel, më 2010,
8. Direktiva 95/46 e KE e Parlamentit dhe e Këshillit e 24 Tetorit 1995,
9. Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Republikës së Kosovës, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr.70/V/, i hyrë në fuqi në maj, 2010, Prishtinë.
10. Valentina Kondili E DREJTA CIVILE I Pjesa e pergjitheshme, Ribotim, Geer, 2008, Tiranë.
11. DZLP, KOMENTAR Na zakonot za Zaštita na ličnite podatoci, Skopje, 2010,
12. Ligji për Mbrojtjen e të dhënave personale i Republikës së Shqipërisë,
13. Zakon za Zaštitu Lični Podataka Republike Crne Gore,
14. Kushtetuta e Republikeë së Kosovës,
15. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë,
16. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
17. Ustav Republike Crne Gore.